



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM**

Nr. 82/ Datë 20.10.2007

**PËR
MIRATIM FONDI PREJ 500.000 LEKË PER KONCERTIN RECITAL
TE KENGETARES LINDITA THEODHORI « Artiste e Merituar »**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës për "PËR MIRATIM FONDI PREJ 500.000 LEKË PER KONCERTIN RECITAL TE KENGETARES LINDITA THEODHORI « Artiste e Merituar », bazuar në Ligjin nr.8652 , date 31/07/2000 " Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika "dh", Ligjin nr.8379.date 09/09/1998 "Per buxhetin lokal", Ligji nr.9645. date 27/11/2006 " Per buxhetin e shtetit te vitit 2007 ", Udhezimin nr. 353 .date 19/03/2007 te Ministrise se Brendeshme " Per zbatimin e buxhetit te qeverisjes vendore per vitin 2007 ", Udhezimin e Ministrise se Financave nr.2 .date 17/01/2007 " Per zbatimin e buxhetit te shtetit per vitin 2007", Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.228,date 13/04/2001"Per dietat e nepunesve qe dergohen me sherbim jashte vendbanimit te tyre" si dhe V.K.B. nr2 date 02/02/2007" Mbi miratimin e buxhetit te Bashkise dhe institucioneve te varesise per vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1.Të miratojë fondin prej 500.000 lekë për Koncertin recital të këngëtares Lindita Theodhori « Artiste e Merituar ».

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i kursyer i shpenzimeve operative të Qendrës Ekonomike të Kulturës « Vangjush Mio » sipas kësaj strukture buxhetore :

Pakësohet 00 08250 5 *Art 6020000(Qen Ek Kulturës)* - 500 000 lekë

Shtohet 00 08250 5 *Art 6020000(Teatri AZ Cajupi)* + 500 000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës. Sektori i Kulturës ne Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës (Teatri A.Z.Cajupi).

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE